

Mirëmëngjesi!

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë, Projektbuxheti i vitit 2022 është planifikuar kujdesshëm bazuar në tri shtylla të rëndësishme: rindërtimin dhe rimëkëmbjen, ngjarjet në tregjet ndërkombëtare dhe sfidat e mijëvjeçarit, si dhe vazhdimin e reformave dhe qëndrueshmërinë e burimeve të rritjes në vend. Ky planifikim nuk mund të bëhej ndryshe, sepse programi qeverisës i miratuar disa javë më parë në këtë Kuvend duhet të bëhej i zbatueshëm nëpërmjet këtij projekti. Pas recesionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -4 %, ekonomia po rikuperohet ndjeshëm në vitin 2021. Vlerësimet më të fundit për rritjen ekonomike tregojnë se normat e larta të rritjes, siç ishte tremujori i dytë me 17,89% apo rikuperimi i pjesshëm i treguesve të tregut të punës, stabiliteti i inflacionit dhe i kursit të këmbimit, përmirësimi gradual i balanceve financiare të sektorit privat, si dhe kreditimi në rritje tregojnë se ekonomia shqiptare po e përballon me sukses sfidën e rimëkëmbjes. Dëshmitë se vëllimi i prodhimit në vend, sikurse është rritja e eksporteve në muajin shtator me 33 miliardë lekë, duke u rritur me 31,1 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 39,4 %, në krahasim me muajin gusht, tregojnë se ndikimi afatmesëm i këtyre dy goditjeve në burimet e rritjes ekonomike ka shumë gjasa të jetë i ulët. Rimëkëmbja ekonomike po vjen si rezultat jo vetëm i reduktimi të kufizimeve të marra për kontrollin e pandemisë, por edhe nga besimi që kanë bizneset dhe familjet, nga përmirësimi i kërkesës së huaj, si dhe nga politikat stimuluese monetare dhe fiskale të ndërmarra. Ishin pikërisht këto politika për stabilitetin monetar edhe financiar të vendit që nxitën kreditimin e ulët në aktivitetin ekonomik, si dhe lehtësuan barrën financiare të sektorit privat. Ky projektbuxhet bazohet në një planifikimin me rritje pozitive dhe të qëndrueshme për vitin 2022 prej 7,6%, por edhe me një rritje të qëndrueshme për periudhën afatmesme 2022-2024 me një rritje mesatare nga 3,7% në 4 % në vit. Projektbuxheti parashikon të ardhura në vlerën 536,8 miliardë lekë ose 8% më shumë sesa i pritshmi i këtij viti.

Projektbuxheti planifikon shpenzimet publike në vlerën 637,7 miliardë lekë ose 34,1% e prodhimit të brendshëm bruto. Për deficitin buxhetor dhe borxhin publik duhet të bëjmë dy sqarime shumë të rëndësishme. Në periudhën 2013-2019 ne u karakterizuam nga një trajektore e sigurt e konsolidimit fiskal. Deficiti në masën 5% e prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2013 rezultoi më pak se 2% në vitin 2019, por situata e jashtëzakonshme diktoi përdorimin me kujdes nën këshillimin ndërkombëtar të klauzolave të devijimit nga rregullat fiskale të parashikuara në ligjin organik të buxhetit të ndryshuar në vitin 2008 e më pas në vitin 2016. Rrjedhimisht, deficiti i përgjithshëm buxhetor arriti në vlerën rreth 6,8% të prodhimit të brendshëm bruto dhe borxhi publik u rrit në rreth 76% të prodhimit të brendshëm bruto. Këto reagime nuk ndodhën vetëm në ekonominë shqiptare, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. Tashmë prej vitit 2022 dhe në vijim objektivi themelor i politikës fiskale është të sigurojë stabilitetin makroekonomik dhe premisa thelbësore për një rritje të qëndrueshme, duke mbajtur nën kujdes deficitin buxhetor, i cili planifikohet të jetë 5,4% e prodhimit të brendshëm bruto nga rreth 6,8 që është për këtë vit! E nderuar Kryetare, Ky buxhet do të këtë në vëmendje të gjithë qytetarët në Republikën e Shqipërisë, së pari duke u kujdesur për shëndetin e tyre

nëpërmjet vaksinimit me dozën buster ndaj COVID – 19. Për këtë qeveria do të vendosë në dispozicion 2,7 miliard lekë. Gjithashtu, ky buxhet do të vazhdojë me transfertat sociale të drejtpërdrejta familjet në nevojë, duke rritur me 10% ndihmën ekonomike për 68 mijë familje, duke dyfishuar ndihmën ekonomike për 15 mijë familje me fëmijë deri në 18 vjeç dhe duke trefishuar atë për familjet me fëmijët jetime ose gra të dhunuara. Qeveria do të vazhdojë të transferojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në buxhetet familjare jo vetëm pagesën për ndihmën ekonomike, por edhe pagesën e papunësisë në shumën e 900 milionë lekëve. Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2022 parashikohet në masën 149 miliardë lekë ose 8% e prodhimit të brendshëm bruto. Nga ky fond është parashikuar të kalojë për pensionistët një shumë prej 2,6 miliardë lekësh për indeksimin dhe 3,5 miliardë lekë për bonusin e fundvitit. Shpenzimet e skemës së sigurimeve të kujdesit shëndetësor do të shkojnë në masën 52,8 miliardë lekë nga 46,1 miliardë lekë të planifikuara për këtë vit. Shpenzimet për fondin e kompensimit të pronarëve parashikohen në total në masën 5 miliardë lekë.

Ndërkohë, në këtë buxhet është përllogaritur edhe një pagë prej 30 mijë lekësh të rinj në muaj për naftëtarët e Fierit për të gjithë vitin 2022, derisa qeveria të gjejë një zgjidhje përfundimtare për rafinerinë. Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh, kurse për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2, 2 miliardë lekësh. Rritja e pagës mesatare këtë vit do të shoqërohet për të gjitha kategoritë: paga minimale mendohet të rritet me 6,6% dhe deri në fund të mandatit me 33%, pagat e disa kategorive do të përfitojnë rritje prej 6%; pagat për 18 mijë mjekë dhe infermierë, 36 mijë punonjës të arsimit dhe 2 mijë punonjës të mbrojtjes civile, 30% rritje page për Forcat e Armatosura, 150% bonus page për punonjësit e policisë jashtë vendbanimit, zero tatim për pagat deri në 40 mijë lekë, përgjysmohet tatimi për pagat 400-500 mijë lekë, duke lehtësuar edhe 59 993 punonjës, thujtë përgjysmojmë tatimin mbi pagën për profesionistët e kualifikuar me paga nga 1,5 deri në 2 milionë të vjetra. Këto tregojnë që projektbuxheti i vitit 2022 është projektuar për të reduktuar pabarazinë dhe, në të njëjtën kohë, për të ofruar stimuj të mëtejshëm për ekonominë. Kjo është një politikë e mirëmenduar, e hartuar me kujdes mbi bazën e statistikave dhe llogarive të shtetit. E nderuar zonja Kryetare, Gjithashtu, ky është edhe projektbuxheti i digjitalizimit, ku reforma e digjitalizimit, me një qendër qytetarin, konsiderohet një instrument i rëndësishëm, për të rritur cilësinë e shërbimeve ndaj biznesit dhe qytetarëve, por edhe luftën kundër korrupsionit.

Sot, falë punës së profesionisteve tanë, databazat e të dhënave janë vendosur në sisteme që kanë ndërveprim midis tyre dhe brenda 31 dhjetorit të këtij viti do të mbyllet cikli i të gjitha shërbimeve online, si për ato që vijnë formë aplikimi, por edhe ato që kanë nevojë për një përgjigje përfundimtare, të dhënë nëpërmjet platformës digjitale me vulë elektronike, pa pasur nevojë të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me zyrat e shtetit. Platforma e bashkëqeverisjes, për të cilën diskutuam pak kohë më parë në Kuvend, solli një nivel të ri komunikimi të zyrave për marrëdhëniet me publikun me qytetarët dhe bizneset. Digjitalizimi, i kombinuar me platformën e bashkëqeverisjes, vendosi në kontroll më të plotë performancën e gjithë trupës së administratës publike, e caktuar për të çuar përpara punët dhe për të zgjidhur shqetësimet e qytetarëve. Gjurmimi i çdo shërbimi, ankese apo shqetësimi e vendos përpara një procesi llogaridhënieje çdo punonjës të administratës. Gjatë këtij mandati ne duam të sigurojmë shërbime për qytetarët pa sportele në territor, të eliminojmë kontaktin fizik, duke hequr mundësinë që pritja ose radha të jetë e qëllimshme, të garantojmë që, sa herë qytetari bën kërkesën dhe ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, sistemi i të dhënave ndërvepron dhe i jep një zgjidhje të shpejtë, pa e çuar atë në shumë dyer, por duke i dhënë një formë shërbimi digjital dhe me vulë elektronike.

Gjatë kësaj kohe ne kemi bërë të mundur që procesi i verifikimit të shërbimeve publike të funksionojë nëpërmjet një karte informative për çdo shërbim. Janë plot 1209 kartela të hartuara, të cilat lidhin momentin e aplikimit me vetë qytetarin për ta informuar atë më mirë se çfarë lloj shërbimi është ai

që kërkohet dhe sa kohë duhet për ta marrë. Tani ne po punojmë që standardet e shërbimeve, që ofrohen për qytetarët ose biznese, të harmonizohen në 71 agjencitë qendrore nëpërmjet vendosjes së një platformë mbi standardet. Këto standarde do të jenë objekt monitorimi i vazhdueshëm dhe çdo rekomandim pas monitorimit do të udhëheqë përmirësimin duke pasur në vëmendje uljen e shkallës së burokratizimit dhe kostos së shërbimit. Duke qenë se janë praktika të reja, të realizueshme, është e rëndësishme që si për qytetarin, ashtu edhe për punonjësin e administratës publike të ketë edukim në vazhdim. Për këtë qëllim do të ofrohen edukime për të gjithë anëtarët e administratës publike si nëpërmjet ASPA-s, ashtu edhe nëpërmjet projekteve nga të tretët. Digjitalizimi do të shtrihet edhe në kadastrë, duke hequr një herë e mirë barrën e qytetarit për të marrë informacionin që do nëpërmjet platformës digjitale, pa sportele në të gjithë territorin e vendit, duke i dhënë atij një dokument me vulë elektronike sa herë që e ka të domosdoshme. Digjitalizimi do të shtrihet edhe në mbrojtjen e territorit dhe sigurisë publike. Qendra digjitale e qarkullimit rrugor është projekt në proces dhe shtrirja e kamerave inteligjente në akset kryesore kombëtare monitoron në kohë reale qarkullimin dhe jep të dhëna për ligjshmërinë e qarkullimit. Pa dyshim që këto procese digjitalizimi kërkojnë një brez të aftësuar teknologjikisht, ndaj edukimi teknologjik i fëmijëve dhe të rinjve, si dhe financimi i drejtpërdrejtë i startup -eve përbëjnë një paketë që në buxhetin e vitit 2022 shton me 6,5 miliardë lekë të ardhurat për teknologjinë.

Ndërkohë, me fondet e të tretëve kjo shumë mund të shkojë në 100 milionë dollarë për vitin 2022. Për të gjithë këtë vëmendje në hartimin e projektbuxhetit jo vetëm për këta sektorë, por për të gjithë sektorët që kolegët e mi ministra prezantuan këtu përpara jush, ju ftoj ta votoni ligjin e buxhetit dhe të fillojmë kështu zbatimin e një programi qeverisës, ku angazhimi për një zhvillim të qëndrueshëm në zbatim të agjendës 2030 po merr jetë. Faleminderit dhe punë të mbarë!